



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.752/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbon Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Arbon Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me shenjën ZL.Anr.752/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.752/2017 me datën 09.11.2017 në ora 15:45, nga parashtruesi Arbon Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se në qendrën votimit 2101x pritshmëria e votave ka qenë 100 vota ndërsa i posedon vetëm 41, QV 2101B pritshmëria ka qenë 130 vota ndërsa posedon vetëm 39 vota, si dhe në QV 2127 B pritshmëria ka qenë 30 vota, ndërsa i posedon 0 vota. Kërkon nga PZAP-i që të shqyrtoj ankesën e tij.

Parashtruesi i ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimit ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.752/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltenë Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*